



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:038744

Datë: 14.10.2024

Numri i dokumentit: 06295246

C.nr.463/2020

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA VITI, gjyqtari Arben Xheladini, me bashkëpunëtoren profesionale Lumturije Fetahu Xhelili, në çështjen kontestimore të paditësit, Z.R.nga fshati R., Komuna e Vitisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson T.A., avokat nga në Viti, kundër të paditurit, X.S.nga fshati L., Komuna e Vitisë dhe A.V..nga fshati R., Komuna e Vitisë, tani me vendbanim të panjohur, të cilit gjykata ia caktuar përfaqësuesin e përkohshëm, S.S., avokat në Viti, me objekt kontesti vërtetimi i të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 6,000.00 euro, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin kryesor më datë 25.09.2024, jashtë seances mori dhe më datë 11.10.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I.Refuzohet e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Z.R., kundër paditurve X.S.dhe A.T., me të cilën ka kërkuar të vërtetohet se paditësi, në bazë të mbajtjes me mirëbesim, e ka fituar të drejtën e pronësisë në ngasten 00050-0, në vendin e quajtur "L.", ZK R., në sipërfaqe të përgjithshme prej 3684 m², të detyrohet i padituri X.S.që paditësit t'ia pranoj këtë të drejtë dhe të duroj që paditësi ta regjistroj në librat kadastrale, dhe kërkesa për shpenzime të procedurës në shumë të përgjithshme prej 1442.60 Euro.

II. I padituri X.S.i bartë shpenzimet e veta të procedurës, ndërsa, përfaqësuesit të përkohshëm, avokatit S.S.i njihen shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 374 Euro, të cilat do të paguhen nga depozita civile, ndërsa, pjesa e mbetur prej 343 do t'i kthehet paditësit pas plotësimit të kushteve ligjore.

A r s y e t i m

Paditësi, Zeqirja R., më datë 10.03.2020, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Gjilan-Dega Viti, kundër të paditurit, X.S.me të cilën ka kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë, në bazë të shitblerjes dhe mbajtjes së ndërgjegjshme, në ngasten 00050-0, me sipërfaqe 3684 m² në vendin "L." ZK R.. Prendimet për këtë kërkesë i ka mbështetur në atë se I.R. (baba i paditësit) këtë nagstër e kishte blerë në fund të vitit 1999 ose fillm të vitit 2000 nga pronari faktik i saj, I.S.nga fshati Remnik, të cilit ia kishte paguar çmmin e kontraktuar prej 12000 DM të atëhershëm, se gjithë familja e paditësit kishin njohuri për tokën e blerë, kishin hyrë në posedim të papenguar nga askush, ashtu që Hysen R. (vëlla i paditësit) e kishte punuar dI. vite. Se babai i paditësit i kishte paguar dI. punëtor për ta pastruar ngastren nga mbeturinat. Pasi paditësi e kishte kuptuar se ngastra ishte bartur në emër të të paditurit, X.S., kishte tentuar të bënte ndonjë marrëveshje me të

por nuk kishte pasur sukses. Ndërsa, më datë 12.03.2020 e ka ndryshuar padinë në kuptim subjektiv real pasiv duke e paditur edhe V.A.¹.

Këto pretendime i ka përsëritur edhe në seancën përgatitore, shqyrtim kryesor dhe fjalë përfundimtare, me arsyetimin se nga administrimi i provave materiale dhe personale është vërtetuar kërkesëpadia e paditësit dhe ka kërkuar që gjykata t'ia miratoj kërkesëpadinë dhe të vërtetoj se paditësi, me mbajtje me mirëbesim është pronar i ngastres 00050-0, e cila gjendet në vendin e quajtur "L.", ZK R., në sipërfaqe të përgjithshme prej 3684 m². Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë prej 1442.60 Euro.

Duke komentuar përgjigjen në padi të të paditurit X.S., përfaqësuesi i paditësit ka theksuar se ky i paditur ngastren kontesutese e kanë posedim nga viti 2017, e jo nga viti 2006.

I padituri, X.S., me përgjigje në padi, gjatë gjithë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, propozimet për prova materiale dhe personale, me arsyetimin se paditësi, me asnjë provë shkresore nuk e ka mbështetur pretendimin se babai i tij, në vitin 1999 ngastren kontestuese pronar juridik i të cilës ka qenë i padituri V.A., e kishte blerë nga pronari faktik, I.S.. Tutje, e ka kontestuar legjitimitetin e paditësit për të qenë palë në këtë procedurë, me arsyetimin se me asnjë provë nuk e ka mbështetur pretendimin se është i vetmi trashëgimtar ligjor i rendit të parë, e po ashtu, e ka kontestuar edhe legjitimitetin real pasiv që të jetë palë në procedurë, pasi me paditësin nuk ka pasur raport material juridik. Ka theksuar se ngastren ka në posedim nga viti 2006 në të cilën i ka të ndërtuara dy shtalla pasi merret me bujqësi. Në fjalën përfundimtare i ka kundërshtuar deklaratat e dëshmitarëve, për të cilat ka theksuar se nuk janë kredibile, pasi dëshmitari Z.Z. ka thënë se pronar i tokës kishte qenë një serb i quajtur Sim, ndërsa dëshmitari Q.B.ka dhënë një version tjetër lidhur me pronarin juridik të ngastres dhe poseduesit faktik të saj. Po ashtu, ka pretenduar se paditësi nuk ka arritur që me prova ta mbështesë pretendimin se ngastren kontesutese e ka pasur në posedim nga viti 1999, e as nuk e ka vërtetuar pretendimin se e ka paguar çmimin e kontraktuar.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, V.A., me përgjigje në pad, gjatë gjithë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetimin se paditësi nuk e ka asnjë provë për të vërtetuar pretendimin se me ndonjë punë juridike e ka blerë ngastren kontesutese. Ka shtuar se sipas aktgjykimit C.nr. 428/17, pronësinë në këtë ngastër e ka fituar i padituri X.S.. Nuk i ka kundërshtuar propozimet e paditësit për prova materiale dhe personale, dhe ka në fund ka kërkuar që gjykata ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar; për përpilimin e përgjigjes në padi, shumën prej 104 euro dhe nga 135 Euro për dy seanca, në shumë të përgjithshme prej 374 Euro.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, gjykata i ka administruar këto prova materiale: Certifikaten nr.2234/2019 e datës 22.08.2019, certifikaten nr. 450/2020 e datës 09.03.2020, Aktgjykimin C.nr.428/2017 të datës 03.06.2019, të Gjykates Themelore Gjilan- Dega Viti, dhe i ka dëgjuar dëshmitarët Z.Z., Q.B.dhe Q.M..

Pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, provave materiale dhe personale një nga një dhe të gjithave së bashku, sipas nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

¹ Me aktvendimin C.nr. 463/2020 datë 13.03.2020 gjykata e ka miratuar kërkesën e paditësit për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, të cilën, pas shqyrtimit të kundërshtimit të të paditurit, me aktvendimin e dates 15.02.2024, e ka shfuqizuar. Gjykata e Apelit, me aktvendimin AC.nr.1445/2022 datë 20.06.2022 e ka refuzuar ankesën e paditësit kundër aktvendimin me të cilin ishte shfuqizuar masa.

Me leximin e certifikatës nr. 2234/2019 të datës 22.08.2019, është vërtetuar se ngastra kadastrale 00050-0- ZK R., në vendin e quajtur "L.", me sipërfaqe 3684 m² ka qenë e evidentuar në emër të A.V. pjesa 1/1 e pronës.

Me leximin e certifikatës nr. 450/2020 të datës 09.03.2020 është vërtetuar se ngastra kadastrale 00050-0- ZK R., në vendin e quajtur "L.", me sipërfaqe 3684 m² aktualisht evidentohet në X.S.(Neat), pjesa 1/1 e pronës.

Në bazë të me leximin e aktgjykimit C.nr.428/2017 i datës 03.06.2019, të Gjykatës Themelore Gjilan-Dega Viti, është konstatuar se gjykata e ka miratuar kërkesëpadinë e X.S.t për vërtetim të pronësisë në ngastren 00050-0, ZK R., në vendin e quajtur "L.", me sipërfaqe 3684 m², në atë kohë e evidentuar në emër të V.A..

Përmbledhje e deklaratave të dëshmitarëve

Dëshmitari Z.Z., në seancën e shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se në nëntor të vitit 1999 ishte interesuar që nga Ismajli ta blinte token në L., e pastaj I.-vëllai i dëshmitarit, e kishte bërë pazar blerjen e kësaj toke për çmimin prej 13000 Euro, se për këtë i kishte treguar vetë I., duke i thënë se e kishin përpiluar edhe një dokument me shkrim, se 1000 marka ishin paguar menjëherë, e të hollat tjera pas 5-6 ditësh, mirëpo nuk kishte qenë prezent. Se kur I. e kishte blerë këtë tokë, prezent kishte qenë gruaja e Q.B. dhe di. persona të tjerë. Ka shtuar se I. nuk e ka punuar këtë tokë. Se pronar i kësaj toke kishte qenë një serb i quajtur Sim, të cilin e kishte njohur ngase e kishte parë duke i punuar tokat e tij. Se personi i quajtur Sima ia kishte shitur Q.B. oborrin dhe tokën në L., ndërsa nuk kishte njohuri çka kishin bërë më vonë.

Dëshmitari, Q.B., në seancën e shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se ka njohuri ku gjindet toka, nuk e dinte sipërfaqen e saj. E dinte se I., babai i paditësit, e kishte blerë token sepse, në Zvicërr kishin banuar në një ndërtesë, dhe se I. i kishte tubuar paret, se prej Zvicërrës kishte ardhur në Kosovë, mirëpo nuk e dinte nëse ia kishte dhënë shitësit, duke shtuar se I. me djemtë e tij i kishin thënë (dëshmitarit) se çmimi ishte paguar. Nuk kishte njohuri nëse babai i paditësit apo paditësi e kishte pasur në posedim ose nëse e kanë punuar këtë tokë dhe nuk kishte dëgjuar se i ka penguar ndokush. Se këtë tokë, e kishte blerë Jetulla Beqiri, nuk i kujtohej viti, e që pastaj ia kishte shitur Q.B. nga fshati Remnik.

Dëshmitari, Q.M., në seancën e shqyrtimit kryesor, ka pohuar se ka njohuri se ku gjindet toka në L., se në atë kohë flitej që I. e kishte blerë tokë aty afër, nuk kishte njohuri nëse babai i paditësit dhe paditësi e kishin pasur në posedim këtë tokë, e as nuk kishte dëgjuar se babain e paditësit apo paditësin t'i kishte penguar ndokush.

Gjytë shqyrtimit të kësaj çështjeje nuk qe kontestuese se i padituri X.S., në regjistrin kadastral, është i regjistruar pronar juridik i ngastres kontestuese dhe, se pronësinë në këtë ngastër e kishte fituar sipas aktgjykimit C.nr.428/2017 i datës 03.06.2019.

Për paditësin, kontestues ishte fakti nëse ka pasur bazë ligjore që me aktgjykimin C.nr.428/2017 gjykata t'ia njeh X.S.t të drejtën e pronësisë në ngastren kontestuese. Ndërsa, për të paditurin X.S.kontestues ishte fakti nëse paditësi ka legjitimitet real aktiv, nëse vetëm i padituri X.S.ka legjitimitet real pasiv-pasi në padi është pretenduar se ngastra kontestuese ishte blerë nga I.S., nëse paditësi e ka pasur në posedim të pandërprerë për 20 vjet ngastren kontestuese.

Baza ligjore

Bazuar në pretendimet për krijimin e raportit material juridik, ligj i zbatueshëm material është Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (LMTHJP), i datës 30.01.1980. Në nenin 20 të LMTHJP-së është përcaktuar: “E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj”; Neni 28.4 përcakton se “Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimit e kohës prej 20 vjetësh.” Neni 21.1 i LMTHJP-së përcakton: “Koha e nevojshme për parashkrimin fitues fillon të ecë nga ajo ditë kur paditësi e ka marrë në posedim sendin dhe mbaron me kalimin e ditës së fundit të kohës së nevojshme për parashkrim fitues.”

Vlerësimet përfundimtare të gjykatës

Pretendimi i paditësit nëse gjykata ka pasur bazë ligjore që me aktgjykimin C.nr.428/2017 të datës 03.06.2019, X.S.t, tani paditur në këtë kontest, t’ia njihte të drejtën e pronësisë në ngastren 00050-0, ZK R., në vendin e quajtur “L.”, me sipërfaqe 3684 m², u gjet i pabazuar pasi aktgjykimi është i formës së prerë nga data 10.07.2019 dhe, tani të paditurit X.S., i ka shërbyer si titull juridik për t’u regjistruar pronar i ngastres që ishte objekt i kontestit sipas padisë së paditësit. Gjatë këtij shqyrtimi, nuk u paraqit asnjë provë me të cilën do të vërtetohej se aktgjykimi është prishë me ndonjë mjet juridik-në mënyrë që të vlerësohej nëse i padituri X.S.t e ka humbur titulli juridik në bazë të të cilit në Zyren Komonale Kadastrale është i regjistruar pronar i ngastres nga data 11.09.2019, fakt jo kontestues e po ashtu i vërtetuar edhe me certifikatën 450/20, datë 09.03.2020.

Gjatë këtij shqyrtimi, gjykata ka vërtetuar se paditësi me asnjë provë nuk i ka vërtetuar pretendimet se të drejtën e pronësisë e ka fituar me ndonjërin nga bazat ligjore të përcaktuara me nenin 20 të LMTHJP-së. Dëshmitarët e dëgjuar, nuk i vërtetuan pretendimet se babai i paditësit raportin juridik të shitblerjes joformale e kishte krijuar me të paditurin e dytë, e për të cilin nuk ishte kontestues fakti se ka qenë pronar juridik i ngastres kontestuese.

Dëshmitari Z.Z., faktet kryesore i kishte me të dëgjuar - pasi në asnjë pjesë të deklaratës së tij nuk ka pohuar të ketë qenë prezent në ditën që pretendohet se babai i paditësit, ngastren kontestuese e kishte blerë nga I.S., e as kur ishte paguar çmimi i kontraktuar. Për më tepër, ky dëshmitar, ka pohuar se babai i paditësit tokën e kishte lënë ashtu siç ka qenë - të papunuar, duke e demantuar pretendimin e paditësit se babai i tij, e kishte pastruar tokën e blerë nga mbeturinat e shumta dhe pretendimin tjetër se ngastren kontestuese për një kohë të gjatë e kishte punuar Hysen R.-vëlla i paditësit. Po ashtu, dëshmitari pohoi se prona në “L.” kishte qenë në pronësi të një qytetari serb të quajtur Sim, e të cilin deklaroi se e kishte njohur pasi e kishte parë duke e punuar tokën, duke e demantuar pretendimin e paditësit se ngastren kontestuese I.S.e kishte blerë nga pronari juridik/tani padituri i dytë.

Pretendimet e paditësit nuk u mbështeten as me deklaratën e dëshmitarit, Q.B., meqë ky dëshmitar, pohoi të mos kishte njohuri nëse babai i paditësit e ka pasur në posedim ngastren kontestuese. Ky dëshmitar dha version tjetër të kalimit të ngastres kontestuese dorë-më-dorë, pasi theksoi se tokën në L. e kishte blerë J.B., i cili pastaj ia kishte shitur I.S., duke e demantuar pretendimin e paditësit se I.S.këtë ngastër e kishte blerë nga pronari juridik- këtu i padituri i dytë. Pjesa e deklaratës së këtij dëshmitari se babai i paditësit i kishte tubuar të hollat për ta paguar tokën e blerë në L. ishte e parëndësishme sepse nuk u vërtetua se objekt shitblerjeje kishte qenë ngastre që tani është objekt i kontestit.

Pretendimet e paditësit nuk u mbështeten as me deklaratën e dëshmitarit, Q.M., i cili nuk kishte njohuri nëse vërtetë ngastren që ishte objekt i kontestit e kishte blerë babai i paditësit, e as nuk e mbështeti pretendimin e paditësit se këtë ngastër e kishte pasur në posedim. Pjesa e pohimit të

këtij dëshmitari se kishte dëgjuar se babai i paditësit kishte blerë tokë në vendin “L.” u vlerësua e parëndësishme me arsyetimin e dhënë si për dëshmitarin Q.B., e po ashtu, e parëndësishme u vlerësua edhe pjesa e deklarimit se dëshmitari nuk kishte dëgjuar nëse paditësi ishte penguar nga ndokush në posedimin e ngastres meqë dëshmitari mohoi të kishte njohuri se babai i paditësit dhe paditësi ngastrën kontestuese e kishin pasur në posedim.

Pretendimi i paditësit se pronësinë në këtë ngastër e ka fituar me mbajtje me mirëbesim nuk u vërtetua me asnjë provë, pasi asnjë nga dëshmitarët nuk e mbështeti pretendimin se paditësi e ka pasur në posedim ngastren kontestuese. Për më tepër, me aktgjykimin C.nr.428/2017 është vërtetuar se i padituri X.S.e ka fituar të drejtën e pronësisë në këtë ngastër, andaj, dështimi i paditësit për të vërtetuar se këtë ngastër e ka pasur në posedim, e përjashton vlerësimin e mirëbesimit meqë kushtet nga neni 20 i LMTHJP-së duhet të plotësohen kumulativisht. Edhe po ta kishte pasur në posedim, afati prej 20 viteve nuk ka kaluar, meqë aktgjykimi C.nr. 428/17 është i formës së prerë nga data 10.07.2019, më të cilin është vërtetuar se X.S.ka qenë në posedim të ngastres nga vitit 2005, ndërsa, posedimi i është bartur nga Basri Sylejmani e i cili këtë ngastër e kishte blerë nga pronari juridik para shumë viteve.

Nëse vërtetë babai i paditësit, e pastaj edhe paditësi ta kishte pasur në posedim këtë ngastër dhe/ose sikur vërtetë ngastra të ishte punuar për një kohë të gjatë nga vëllai i paditësit, është e palogjikshme se nuk e kanë parë asnjëherë të paditurin X.S.duke e ushtruar pushtetin faktik të ngastres kontestuese. Mbajtja me mirëbesim ndërthun në vehte ushtrimin e pushtetit faktik haptazi, e jo fshehtas; sjelljen e poseduesit me mirëbesim në raport me sendin në atë mënyrë që të reagoj menjëherë ndaj çdo personi, qoftë edhe pronarit juridik të sendit, që pa bazë juridike e shqetëson poseduesin me mirëbesim. Paditësi nuk e vërtetoi pretendimin se posedimin e ka ushtruar haptas dhe pa asnjë pengesë nga fundi i vitit 1999 apo fillimi i vitit 2000, andaj, pretendimi i tij se vetëm në vitin 2020 e ka kuptuar se i padituri është regjistruar pronar i ngastres kontestuese është i pabazuar. Në fakt, paditësi ka qenë kontradiktor rreth kohës së marrjes së ngastrës kontestuese në posedim, duke shënuar në padi se ngastra ishte blerë - citim nga referati i padisë: “diku ka fundi i vitit 1999 ose fillimi i vitit 2000”.

Gjykata ka vlerësuar se, edhe sikur paditësi të vërtetonte pretendimin se babai i tij ngastren kontestuese e kishte blerë dhe mbajtur në posedim të paktën për 20 vjet, kërkespadija e tij do të refuzohej me arsyetimin se paditësi nuk mund të disponoj me këtë kërkesë, pasi me asnjë provë nuk e ka mbështetur pretendimin në raport me këtë send: si u bë që kjo paluajtshmëri e blerë nga babai i tij, i ka mbetur vetëm paditësit e jo edhe trashëgimtarëve ligjor të tjerë, kur gjykata e ka të njohur faktin se të paktën paditësi e ka pasur një vëlla-sipas paditësit tashmë i vdekur, e për të cilin ka pretenduar se e ka punuar ngastren kontestuese për shumë vite.

Pretendimi i të paditurit, X.S., se në këtë kontest nuk janë përfshirë personat me të cilët babai i paditësit e ka krijuar raportin juridik, është vlerësuar i pandikim në këtë çështje. I padituri X.S., si pronar i regjistruar i ngastres kontestuese formalisht duhet të jetë i përfshirë në këtë proces kontestimor dhe paditësi nuk ka pretenduar se me këtë të paditur ka pasur ndonjë raport material juridik. E rëndësishme në këtë proces është se paditësi me asnjë provë nuk e ka vërtetuar pretendimin se babai i tij, ngastren kontestuese e ka blerë nga pronari juridik dhe/ose pushtetin faktik e ka të bartur nga mbajtësi faktik-shitësi i pretenduar I.S., e as pretendimin se I.S.ngastren kontestuese e kishte blerë nga i padituri i dytë.

Paditësi, si inicues i kësaj procedurë kontestimore e ka pasur barrën e provës sipas nenit 7.1 të LPK-së që përcakton: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla” dhe nenit 322.2 të LPK-së sipas të cilit: “Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që

është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”, e që gjatë këtij procesi kontestimor nuk arrit që me provat e propozuara t’i vërtetoj pretendimet e tij.

Vendimi për shpenzimet procedurale

Meqë paditësi e humbi kontestin gjykata ia refuzoi edhe kërkesën për shpenzime të procedurës – shpenzimeve që i referohen taksës gjyqësore 50 Euro, përpilimit të padisë 104 dhe 779 Euro për pjesëmarrjen e përfaqësuesit të tij në seancat e shqyrtimit dhe veprime të tjera procedurale. Edhe sikur paditësi të kishte sukses në procedurë, shuma e kërkuar prej 779 Euro do të refuzohej pasi kërkesa për shpenzime nuk është specifikuar sipas nenit 463 të LPK-së. I padituri X.S.nuk i ka kërkuar shpenzimet.

Përfaqësuesi i përkohshëm do të paguhet nga depozita civile që paditësi, para fillimit të shqyrtimit kryesor, e ka deponuar shumën prej 717 Euro. Përfaqësuesit të përkohshëm deri në këtë fazë i njihen shpenzimet e procedurës për përpilim të përgjigjes në padi 104 Euro, dhe për dy seanca secila nga 135 Euro, në shumë të përgjithshme prej 334 Euro. Shuma e mbetur nga depozita civile do t’i kthehet paditësit pas plotësimit të kushteve ligjore.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar edhe në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI C.nr.463/2020, më datë 11.10.2024

Gjyqtari,

Arben Xheladini

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.